

ANGAZHIMI QYTETARË

Mangësitë dhe Mundësitë



ANGAZHIMI QYTETARË

Mangësitë dhe Mundësitë

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	7
HYRJE.....	8
I. METODOLOGJIA	9
II. SA DHE SI KONSULTOHEN QYTETARËT NGA NIVELI KOMUNAL.....	10
III. SA DHE SI KONSULTOHEN QYTETARËT NGA NIVELI QENDROR	20
IV. KONSULTIMET ME QYTETARË NGA PARTITË POLITIKE	24
V. AKTIVIZMI QYTETARË	29
1. Veprimet e ndërmarra në relacion me komunën	29
2. Iniciativat qytetare në lagje	30
3. Peticionet.....	30
VI. INFORMIMI I QYTETARËVE PËR AKTIVITETET E NIVELIT LOKAL.....	34
VII. KËRKESAT E QYTETARËVE	38
VIII. ÇFARË QEVERISJE E VLERËSOJNË QYTETARËT.....	41
IX. PREMTIMET ZGJEDHORE DHE VOTA QYTETARE	44
X. SHTOJCAT	46

Ky publikim është përgatitur me përkrahjen e Fondacionit Konrad-Adenauer, Zyra në Prishtinë.

Përgatitur nga:



Përkrahur nga:



E drejta e autorit © 2019. Demokraci Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Demokraci Plus dhe Konrad-Adenauer Stiftung. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetei elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+. Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Konrad-Adenauer Stiftung.



Të gjeturat e këtij studimi tregojnë se në përgjithësi qytetarët nuk janë shumë aktiv në jetën publike qoftë në nivelin lokal, qendror, parti politike apo edhe në komunitetet e tyre. Gjithashtu, institucionet e të dyja niveleve nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për t'i dëgjuar dhe pastaj adresuar kërkesat e qytetarëve.

PËRMBLEDHJE

Aktivizmi qytetarë në Kosovë dhe në të njejtën kohë, përpjekja e institucioneve për t'i angazhuar dhe inkuadruar qytetarët në qeverisje, ka vend për përmirësim. Të gjeturat e këtij studimi tregojnë se në përgjithësi qytetarët nuk janë shumë aktiv në jetën publike qoftë në nivelin lokal, qendror, parti politike apo edhe në komunitetet e tyre. Gjithashtu, institucionet e të dyja niveleve nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme për t'i dëgjuar dhe pastaj adresuar kërkesat e qytetarëve.

Në këtë aspekt, më mirë qëndron qeverisja lokale se sa ajo qendrore duke qenë se 47.7% e qytetarëve kanë dëgjuar për ndonjë konsultim publik të organizuar nga Kryetari apo Kuvendi Komunal në dy vitet e fundit në komunën e tyre, krahasuar me vetëm 9.4% të atyre që pohuan se kanë marrë pjesë në ndonjë konsultim publik të organizuar nga Kuvendi i Kosovës. Qëndrim të ngjashëm qytetarët kanë edhe për sa i përket organizimit të konsultimeve nga deputetët, me vetëm 35.5% të respondentëve që tregojnë gatishmëri të marrin pjesë në një konsultim në lagje të tyre nëse një i tillë organizohet nga deputetët(t).

Mirëpo edhe në nivel të komunave, angazhimi institucional për t'i mbajtur qytetarët afër qeverisjes ka hapësirë për përmirësim. Kjo vlen sidomos në aspektin e promovimit të mundësive për angazhim, konkretisht informimit më të mirë të qytetarëve për mekanizmat e konsultimit si dhe rreth organizimit të konsultimeve publike. Fakti që 56.9% të qytetarëve kanë thënë se do të marrin pjesë në një konsultim nëse do të informoheshin për një të tillë dhe 67.4% të tyre nuk kanë marrë pjesë në një konsultim publik të organizuar nga komuna sepse nuk kanë qenë të informuar, tregon që komunat janë përgjegjëse në masë të madhe për pjesëmarrje të vogël të qytetarëve në konsultime. Për më tepër, shqetësuese është e gjetura se 51% të qytetarëve nuk marrin pjesë në këto ngjarje sepse besojnë që kërkesat e tyre nuk merren parasysh.

Në anën tjetër, interesimi i qytetarëve për angazhim në jetë publike nuk është në nivelin e duhur. Kjo tregohet nga përqindja e vogël e qytetarëve që kërkojnë përgjigje nga zyrtarët përgjegjës, ku 16.3% e respondentëve pohojnë se kanë kërkuar takim me kryetarin, 9.9% i kanë telefonuar komunës për ankesa/kërkesa, 9.4% kanë kontaktuar me komunën apo kryetarin përmes rrjeteve sociale dhe vetëm 3.8% kanë raportuar online për ndonjë ankesë. Po ashtu, gjatë vitit të fundit vetëm 23.6% të respondentëve kanë komunikuar me ndonjë zyrtar publik nga niveli lokal apo qendror, dhe pak më shumë se një e treta (1/3) e respondentëve kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga banorët e lagjes. Gjithashtu, 48.2% kanë thënë se, asnjëherë nuk kanë pranuar ftesë apo kërkesë për ta nënshkruar një peticion dhe vetëm 18.80% e respondentëve kanë pohuar të kenë marrë pjesë në ndonjë aktivitet të një partie politike përtej zgjedhjeve. Kjo tregon për mungesën e iniciativave të qytetarëve për të ndërmarrë hapa konkret për përmirësim të lagjeve/vendbanimeve të tyre por gjithashtu edhe mosinteresim për angazhim në jetën politike në mes të cikleve zgjedhore.

Gjetje tjetër me rëndësi është fakti që kur marrin pjesë në konsultime publike, kërkesat që qytetarët i adresojnë në këto ngjarje janë kryesisht për investime në lagjet e tyre dhe për mundësi punësimi pranë komunës. Poashtu, në një situatë hipotetike nëse komuna e tyre do t'i pyeste se ku ta investonte një shumë të konsiderueshme të fondeve, përgjigja dominante është investimi në shtëpi të shëndetit dhe infrastrukturë rrugore, duke lenë të nënkuptohet se niveli i investimeve nga komuna nuk është i kënaqshëm dhe se këto investime mungojnë në sektorët kyq që e determinojnë kualitetin e jetës së qytetarit.

Mbi të gjitha, aspekti që vlerësohet më së shumti në qeverisje është qeverisja pa korrupsion, që vlerësohet dukshëm më shumë se sa mbajtja e premtimeve zgjedhore apo edhe udhëheqja duke konsultuar qytetarët.

HYRJE

Një qeverisje e mirë kërkon që t'i konsultojë dhe informojë qytetarët për çështjet që i ndikojnë ata drejtpërdrejtë. Konsultimet e rregullta me qytetarët, qoftë për buxhet apo për çështje specifike me rëndësi për banorët, por edhe takimet publike për informim të qytetarëve janë esenciale për një qeverisje të përgjegjshme, efektive dhe gjithëpërfshirëse. Për më tepër, involvimi i qytetarëve në vendimmarrje ndikon në rritje të kualitetit të shërbimeve të ofruara dhe në shpenzim të buxhetit të komunës në proporcion me nevojat e qytetarëve të saj.

Në një shoqëri demokratike, qytetarët marrin rol aktiv në jetën publike duke u angazhuar si pjesëtar të komunitetit dhe duke kërkuar llogari si votues dhe taksapagues. Njëher-

it ata japin kontributin e tyre në qeverisje, e sidomos në nivelin lokal i cili vendos për politika që prekin drejtpërsëdrejti kualitetin e jetës së tyre. Ky angazhim vjen përmes pjesëmarrjes në votim, pjesëmarrjes në diskutime publike e dëgjime buxhetore me komunën, organizim të takimeve në lagje, peticioneve për çështje të ndryshme me interes të komunitetit, pjesëmarrje në diskutime publike me Kuvendin, deputetë individual dhe parti politike, ndër të tjerash.

Ky hulumtim është ndërmarrë me qëllim të matjes së nivelit të angazhimit institucional rreth përfshirjes së qytetarëve në qeverisje dhe informimit të tyre, si dhe matjes së aktivizimit të vetë qytetarëve në jetën publike.

I. METODOLOGJIA

Të dhënat janë mbledhur nga një mostër përfaqësuese e popullatës në nivel të Kosovës, me 1070 të anketuar. Mostra është përzgjedhur sipas etniciteteve: shqiptar, serb dhe minoritete joserbe, me mbipërfaqësim të komuniteteve joshumicë dhe peshim të mostrës për analizë. Shtrirja e vendbanimeve të respondentëve ka qenë me ndarje pothuajse të barabartë në mes të vendbanimeve urbane (47.7%) dhe rurale (52.3%).

Përzgjedhja e mostrës së amvisërisë është bërë duke shfrytëzuar metodën sistematike të rastësisë, ndërsa zhvillimi i anketës është bërë me personin (mbi 18 vjeç), i cili e ka datën e lindjes që është më e afërt me ditën kur është zhvilluar anketa. Anketimi është bërë ballë për ballë, ku anketuesi i ka lexuar pyetjet respondentit dhe ka shënuar përgjigjet në pyetësorin elektronik. Mostra është e ndarë në numër pothuajse të barabartë ndërmjet burrave dhe

grave, konkretisht 50.7% e respondentëve kanë qenë burra dhe 49.3% gra. Moshë e respondentëve varion nga 18 deri në mbi 65 vjeç, të cilat janë ndarë në gjashtë grupe për arsye të analizimit të të dhënave.

Margjina e vendosur e gabimit është $\pm 3\%$, me interval të konfidencës prej 95%. Për realizim të këtij studimi, janë angazhuar 25 anketues, së bashku me katër ekipe mbikëqyrëse që kanë verifikuar punën për të siguruar cilësinë e procesit të intervistimit. Po ashtu, 30.4% e anketave të realizuara janë verifikuar përmes thirrjeve telefonike dhe vizitave në terren.

II. SA DHE SI KONSULTOHEN QYTETARËT NGA NIVELI KOMUNAL

Komunat janë të detyruara që përmes kryetarit dhe kuvendit komunal t'i konsultojnë qytetarët për procese dhe çështje të ndryshme me interes publik. Këtu përfshihen diskutimet publike që mbahen nga komuna për buxhet, investime, tema të përgjithshme apo edhe specifike që e prekin një vendbanim të caktuar. Në fakt, mbajtja e të paktën dy takimeve publike brenda vitit është obligim ligjor për komunat¹. Nga qeverisja komunale pritet të ketë edhe konsultime me qytetarë për çështje dhe procese specifike si buxheti, planet urbane dhe rregulloret për fusha të ndryshme nën kompetencë të komunës. Numri minimal i diskutimeve publike siç kërkohet me legjislacion mbahet në përgjithësi nga të gjitha komunat, megjithatë ka raste kur konsultimet organizohen dhe mbahen vetëm për ta përmbushur obligimin ligjor.

Informatat e paraqitura në grafet në vazhdim e pasqyrojnë situatën në lidhje me nivelin dhe mënyrën e konsultimit të qytetarëve nga niveli lokal i qeverisjes.

Pothuajse gjysma e respondentëve në nivel të përgjithshëm janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen se a kanë dëgjuar për ndonjë konsultim publik që ka mbajtur kryetari apo kuvendi komunal në dy vitet e fundit në komunën e tyre. Sa i përket gjinisë, burrat dalin më të informuar se sa gratë për konsultimet publike, me 53% dhe 42.3% respektivisht. Nga ana tjetër nuk ka ndonjë dallim të theksuar ndërmjet dy grupeve më të mëdha etnike, mesatarisht gjysma e respondentëve shqiptarë dhe gjysma e atyre serbë kanë thënë se janë të informuar për konsultime publike që mbahen nga kryetari apo kuvendi i tyre komunal. Moshat e reja duket të jenë më të informuar për këtë çështje, ku në grupmoshat 18-24 dhe 25-34 ka më së shumti përgjigje pozitive. Sa i përket nivelit të edukimit, respondentët që janë studentë dhe ata me fakultet të përfunduar kanë më shumë njohuri për konsultimet publike në komunën e tyre se sa grupet tjera, me 62.4% dhe 63.7% respektivisht. Nga kategoritë e ndryshme të të punësuarve, ata me të ardhura më të larta personale, përkatësisht me pagën prej 601-750 euro (76.2%) dhe ata me paga në kategorinë mbi 900 euro (73.3%) janë më të informuarit lidhur me organizimin dhe rëndësinë e konsultimeve publike. + (SHIH FIGURËN 1)

¹ Ligj Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale. Kreu IX "Demokracia e Drejtëpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes Qytetare". Neni 68: "Informimi publik dhe konsultimi". Gazeta Zyrtare, 2008.



A jeni njoftuar për ndonjë konsultim publik në komunën tuaj




FIGURA 1.
Pyetja: A keni dëgjuar për ndonjë konsultim publik që ka mbajtur Kryetari apo Kuvendi Komunal në dy vitet e fundit?

Fusha më e rëndësishme për konsultim




FIGURA 2. Sa është e rëndësishme për ju që të konsultohuni nga komuna për këto procese (rango 1- Aspak deri në 5- Plotësisht, për nga rëndësia e tyre):

Anketa u ka ofruar qytetarëve të zgjedhin fushën më të rëndësishme për konsultim, nga katër temat më të shpeshta për të cilat mbahen në fakt mbahen konsultime publike. Në përgjithësi të katër proceset e paraqitura si çështjet më të shpeshta për të cilat komunat i konsultojnë qytetarët (buxheti i komunës, tatimet komunale, planet urbanistike të lagjes dhe hapësirat gjelbëruese) u vlerësuan si tejet të rëndësishme për tu konsultuar nga komuna. Vlerësimet variojnë nga notimi me 4.06 për hapësirat gjelbëruese e deri në 3.8 për buxhet dhe tatime, por në përgjithësi asnjëra nga këto tema nuk vlerësohet me pikë maksimale (5) apo më poshtë se 3.8 sa i përket rëndësisë së tyre për t'u konsultuar me qytetarë. Gjithashtu, sa i përket grupmoshave (Shih shtojcën 1), nuk ka dallim të dukshëm në vlerësim përderisa përgjigjet për katër kategoritë nga gjashtë grupmoshat variojnë nga 3.5 deri në 4.4. Diskutimi për hapësirat gjelbëruese merr më së shumti pikë në të gjitha grupmoshat, ndërsa vlerësimi i rëndësisë së diskutimit për tatime rritet në proporcion me moshën, pra sa më e madhe moshja, aq më i rëndësishëm konsiderohet konsultimi nga komuna për temën e taksave. Po ashtu, moshat më të mëdha e vlerësojnë më shumë nevojën për t'u konsultuar nga komuna për buxhetin dhe për planet urbanistike të lagjeve. **+** (SHIH FIGURËN 2)

Duke u nisur nga fakti që komunat nuk angazhohen mjaftueshëm në aspektin e informimit të publikut për mbajtjen e konsultimeve publike, qytetarët janë pyetur nëse do të merrnin pjesë në një konsultim të tillë po të njoftoheshin paraprakisht.

Gatishmëria për të marrë pjesë në konsultime publike ka rezultuar të jetë mjaft e lartë në nivel të përgjithshëm, ku më tepër se gjysma (56.9%) e të aketuarve kanë pohuar se do të merrnin pjesë. Burrat kanë shprehur gatishmëri më të madhe sesa gratë, me respektivisht 65.9% dhe 47.7%. Kjo gatishmëri ka rritje të lehtë me rritjen e nivelit të edukimit, edhe pse në të gjitha kategoritë përqindja është mjaft e lartë. Interesimi më i madh vërehet tek të punësuarit në sektorin publik (65.7%) dhe pensionistët (63.3%), mirëpo është mjaft i dukshëm edhe te të papunët dhe studentët.

Sa i përket kategorive sipas të ardhurave personale, më të gatshimit për pjesëmarrje në konsultime publike janë kategoritë që fitojnë ndërmjet 301 dhe 450 eurove, si dhe 751 dhe 900 eurove. Nëse krahasojmë të dhënat që dalin nga anketa për gatishmërinë e qytetarëve për pjesëmarrje në konsultime publike me pjesëmarrjen reale, ka një diskrepancë të madhe, kjo e fundit është shumë më e ulët. Kjo mospërputhje mund të shpjegohet me mungesën e informatave për organizimin e këtyre takimeve ose për shkak të caktimit të kohës së papërshtatshme për shumicën e qytetarëve.

+ (SHIH FIGURËN 3)

A do të merrnit pjesë në konsultim publik po të njoftoheni?




FIGURA 3. Përgjigjja: Do të merrja pjesë në një konsultim publik nëse do të isha i informuar.

Në një demokraci të mirëfilltë, niveli i konsultimit nga komunat për çështje me interes publik është ndër faktorët determinues të vendimit të qytetarit se për kë do të votojë në zgjedhjet e ardhshme. Se sa vlerësohet qeverisja lokale me pjesëmarrje të qytetarëve përmes konsultimeve publike në Kosovë, shihet përmes rezultatit siç paraqitet në vijim.

Pra, 48.2% e qytetarëve pajtohen deri diku dhe 30.9% pajtohen plotësisht me deklaratën “Niveli i konsultimeve të komunës ndikon në votën time në zgjedhjet e ardhshme”. Dallimet në përgjigje midis gjinive apo vendbanimeve (rurale dhe urbane) janë tejet të vogla. Në anën tjetër, dallimi në përgjigje midis dy etnive është i theksuar, meqenëse

33.8% e shqiptarëve pajtohen plotësisht me deklaratën, ndërsa vetëm 9.3% e respondentëve serbë e kanë përzgjedhur këtë opsion si përgjigje. Interesante është gjetja se, përqindja më e lartë e respondentëve nga moshat më të reja pajtohen plotësisht me deklaratën, dhe kjo përqindje bie në proporcion me rritjen e moshës. Sa më të larta të ardhurat personale, niveli i punësimit por edhe i shkollimit aq më e lartë përqindja e përgjigjeve që vota e tyre ndikohet nga niveli i konsultimeve nga komuna. Interesante janë rezultatet për personat me të ardhura personale mbi 900 euro, ku 12.5% e tyre nuk pajtohen fare me deklaratën, numër ky që përbën shifrën më të lartë të mospajtueshmërisë në krahasim me kategoritë tjera. + (SHIH FIGURËN 4)



Pra, **48.2% e qytetarëve** pajtohen deri diku dhe **30.9% pajtohen plotësisht** me deklaratën “Niveli i konsultimeve të komunës ndikon në votën time në zgjedhjet e ardhshme”. Dallimet në përgjigje midis gjinive apo vendbanimeve (rurale dhe urbane) janë tejet të vogla.

Niveli i ndikimit të konsultimeve publike komunale në votën e qytetarëve




FIGURA 4. Pyetja: Sa pajtoheni me deklaratën në vijim: “Niveli i konsultimeve të komunës me mua si qytetar ndikon në votën time në zgjedhjet e ardhshme”

Arsyet për mospjesëmarrje në konsultime të komunës




FIGURA 5.
Pyetja: Për çfarë arsye nuk keni marrë pjesë në një konsultim publik të organizuar nga komuna?

Arsyeja kryesore e mospjesëmarrjes në konsultimet publike të organizuara nga komuna është të mosinformimi për organizimin e konsultimeve publike (përgjigje e përzgjedhur nga shumica absolute e respondentëve). 51% e respondentëve besojnë se kërkesat e tyre nuk merren parasysh nga komuna, prandaj nuk e vlerësojnë të nevojshme pjesëmarrjen e tyre në konsultime. Gjithashtu, organizimi i konsultimeve në kohë dhe lokacione të papërshtatshme rezultojnë të jetë faktor për mospjesëmarrje, me 27.6% dhe 27.4% respektivisht.

Arsyet kryesore për mospjesëmarrje në konsultime publike nuk variojnë shumë ndërmjet grupmoshave (Shih shtojcën 2). Në të gjitha grupmoshat në fakt, numri më i madh i përgjigjeve bie nën arsyetimin e mosinformimit, pasuar nga mosmarrja parasysh e kërkesave të tyre si qytetarë dhe në fund, me një ndarje pothuajse të barabartë në mes të mospërshtatshmërisë së kohës dhe lokacionit ku është mbajtur diskutimi.

Në anën tjetër, atëherë kur marrin pjesë në konsultime publike, kërkesat që i adresojnë në këto ngjarje janë kryesisht për investimet në lagjet e tyre (45.7%), punësimet nga komuna (31.4%) dhe rreth shërbimeve komunale (29.9%). Përzgjedhja e arsyes “punësim nga komuna” në këtë përqindje të madhe tregon që konsultimet publike shihen si mundësi nga qytetarët për të diskutuar për punësim nga komuna. Mirëpo, diskutimet publike duhet të shfrytëzohen nga qytetarët për të diskutuar për të mirën e përgjithshme të komunitetit dhe jo për interesa të ngushta personale.

Arsyet për pjesëmarrje në konsultime të komunës




FIGURA 6.
Pyetja: Për çfarë arsye keni marrë pjesë në një konsultim publik të organizuar nga komuna?

Dëgjimet buxhetore si lloji më i shpeshtë (dhe obligativ) i konsultimeve publike kanë nevojë për përmirësim në mënyrë që të ketë pjesëmarrje më të konsiderueshme të qytetarëve dhe si rrjedhojë ta arrijnë efektin e tyre që të mbledhin inputin e qytetarëve për atë se si të shpenzohet buxheti në vitin e ardhshëm.

Aspekti kryesor që duhet të përmirësohet rreth konsultimeve publike për buxhetin e komunës sipas respondentëve, është të tregohet buxheti për secilën lagje (55.8%), pasuar nga dhënja e mundësisë për vetëplanifikim të investimeve në lagjet e tyre (53.7%). Po ashtu tejet e rëndësishëm është konsideruar mbajtja e konsultimeve në fazat e para të përgatitjes së buxhetit (40.7%), dhe më pak rëndësi i

është dhënë shpërndarjes së draft-buxhetit dhe mbajtjes së takimit në një orar të përshtatshëm. Aspekt tjetër që vlerësohet të ketë më së shumti nevojë për përmirësim në lidhje me konsultimet publike për buxhet, kryesisht të të gjitha grupmosht (Shih shtojcën 4) është të tregohet buxheti për secilën lagje. Të rinjtë 18-24 vjeç dhe grupmosha 25-34 vjeç kryesisht mendojnë se duhet të tregohet buxheti dhe t’ju jepet mundësia për vetëplanifikim të investimeve në lagje. Këto dy aspekte janë përzgjedhur për nga rëndësia edhe për katër grupmoshat e tjera. Ndërsa, vlerësim të lartë merr edhe nevoja për mbajtje të diskutimit publik në fazën e planifikimit të buxhetit, sidomos nga dy grupmosha, 35-44 vjeç me 41.7% dhe 55-64 vjeç me 41.9%. + (SHIH FIGURËN 7)

Çfarë kërkohet të përmirësohet në dëgjimet buxhetore




FIGURA 7.
Pyetje: Cilat aspekte duhet të përmirësohen në lidhje me konsultimet publike për buxhet?

Pasi që sipas pothuajse një të tretës (1/3) së qytetarëve, arsye për mospjesëmarrje në një diskutim publik komunal është fakti që ato organizohen në lokacione të papërshtatshme, pyetja e rradhës ka mbledhur përgjigje konkrete nga qytetarët për preferencat e tyre për lokacionin e diskutimeve. + (SHIH FIGURËN 8) Qytetarët deklaruan në masë të madhe se do të preferonin që të mbaheshin në shkollën e lagjes së tyre (63.5%) dhe një përqindje e konsiderueshme janë përgjigjur se do të preferonin ndërtesën e komunës (33.8%).

Më të zëshmit për idenë e mbajtjes së konsultimeve në shkollën e lagjes ishin personat e moshuar mbi 65 dhe pensionistët. Ndërsa, mbajtjen e tyre në ndërtesën e komunës e kanë kërkuar ata që kanë të ardhura më të mëdha (62.5%) dhe ata me magjistraturë apo doktoraturë (60%).

Vendi i preferuar për konsultim publik




FIGURA 8.
Pyetje: Në cilin vend do të preferonit të mbahet konsultimi publik i komunës me qytetarë?

III. SA DHE SI KONSULTOHEN QYTETARËT NGA NIVELI QENDROR

Përveç komunave, edhe niveli qendror, përkatësisht Kuvendi i Kosovës është i obliguar që t'i konsultojë qytetarët për ligjet që janë në proces. Konsultimet gjithashtu mund të organizohen nga deputetë individual. Mirëpo, interesi për pjesëmarrje në konsultimet publike të organizuara nga Kuvendi i Kosovës rezulton të jetë tejte i ulët. Vetëm 9.4% e qytetarëve kanë pohuar se kanë marrë pjesë në ndonjë në konsultimet e organizuara nga ky institucion. Përgjigjet nuk tregojnë diferencë ndërmjet gjinive apo vendbanimeve rurale/urbane. Komuniteti shqiptar ka interesim pak më të madh (2.5%) për pjesëmarrje në konsultime për ligje sesa ai serb. Interesimi për pjesëmarrje rritet proporcionalisht me nivelin e edukimit, konkretisht ndër studentët interesimi është treguar me 7.4%, ndër-

sa te personat me magjistraturë ose doktoraturë shkon deri në 12.5%. Sa i përket statusit të punësimit, përgjigje pozitive për pjesëmarrje në konsultime për ligje ka më së shumti ndër të punësuarit në sektorin privat, që tejkalon edhe grupin e të punësuarëve në sektorin publik me 3.8%. Ndër kategoritë me të ardhura personale, interesi më i lartë është te respondentët që fitojnë 601-750 euro dhe tek ata që fitojnë mbi 900 euro në muaj.

+ (SHIH FIGURËN 9)



Komuniteti shqiptar ka interesim pak më të madh (2.5%) për pjesëmarrje në konsultime për ligje sesa ai serb. Interesimi për pjesëmarrje rritet proporcionalisht me nivelin e edukimit, konkretisht ndër studentët interesimi është treguar me 7.4%, ndërsa te personat me magjistraturë ose doktoraturë shkon deri në 12.5%.

Pjesëmarrja në dëgjime publike të Kuvendit të Kosovës




FIGURA 9.

Pyetja: A keni marrë pjesë ndonjëherë në konsultime për ligje të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës?

Qëndrim të ngjashëm qytetarët kanë edhe sa i përket organizimit të konsultimeve nga deputetët. Përgjigje pozitive për pjesëmarrje në konsultim në lagje nëse një i tillë organizohet nga deputetët(t) kanë dhënë vetëm 35.5% të respondentëve, 31.9% janë përgjigjur negativisht, ndërsa 23.2% do ta bazonin vendimin e tyre në faktin se nga cili deputet ftohen. Burrat janë më të gatshëm se sa gratë të marrin pjesë në këto lloj konsultimesh, ndërsa nuk ka ndonjë diferencë të madhe ndërmjet qytetarëve që jetojnë në zona rurale apo urbane. Komuniteti shqiptar tregon më shumë interesim për pjesëmarrje në konsultime të kësaj natyre sesa ai serb, e atë me ndarje përafërsisht të barabartë ndërmjet përgjigjeve “po”, “jo” dhe “varet nga cili deputet do të ftoheshin”. Gjithashtu grupmoshat më të reja (18-24) kanë treguar interesim më të lartë (41.8%) pasuar nga grupmosha 45-54 (38.5%). Të punësuarit në sektorin privat kanë treguar interesim pak më të madh për pjesëmarrje në këto lloj konsultimesh sesa të punësuarit në sektorin publik, ndërsa grupi me interesimin më të madh nga të gjitha grupet, janë studentët/nxënësit. Sa i përket të ardhurave personale, grupet që fitojnë nga 301-450, 451-600 dhe 751-900 euro në muaj kanë dhënë përgjigje pozitive mbi 40%. Për grupin me të ardhura personale mbi 900 euro (53.3%), rëndësi më të madhe ka se cili deputet i fton në atë konsultim publik. + (SHIH FIGURËN 10)



Të punësuarit në sektorin privat kanë treguar interesim pak më të madh për pjesëmarrje në këto lloj konsultimesh sesa të punësuarit në sektorin publik, ndërsa grupi me interesimin më të madh nga të gjitha grupet, janë studentët/nxënësit.

A do të merrnit pjesë në diskutim publik të organizuar nga një deputet?




FIGURA 10. Pyetja: Nëse një apo disa deputet do të organizonin ndonjë konsultim në lagjen tuaj a do të merrnit pjesë?

IV. KONSULTIMET ME QYTETARË NGA PARTITË POLITIKE

Vetëm 18.80% e respondentëve kanë pohuar të kenë marrë pjesë në ndonjë aktivitet të një partie politike jashtë periudhës së zgjedhjeve. Pjesëmarrja del të jetë më e lartë në mesin e burrave se sa e grave, me 20.5% dhe 16.9% respektivisht, dhe pak më e lartë në vendet urbane se sa në ato rurale, por me diferencë prej vetëm 1.7%. Dallimi vërehet në mes të etniciteteve, ku shqiptarët janë më aktiv në aktivitetet e partive pas zgjedhjeve sesa serbët me 19.9% dhe 12% respektivisht. Grupmosha më aktive është ajo prej 45 deri në 54 vjeç, ndërsa nuk ka ndonjë dallim të theksuar në mes të niveleve të ndryshme të edukimit (përveç atyre me shkollë të mesme që janë grupi më pak aktiv me vetëm 15.8%). Të punësuarit në sektorin publik janë më të prirur

për të marrë pjesë në aktivitete të partive jashtë procesit zgjedhor, pasuar nga të punësuarit në sektorin privat dhe studentët. Ndërsa sa i përket kategorisë sipas të ardhurave personale, grupi me interesimin më të lartë është ai me të ardhura 451-600 euro në muaj, ndërsa me interesim të ulët janë ata pa të ardhura dhe ata me të ardhura deri në 150 euro, si dhe ata me 751-900 euro. + (SHIH FIGURËN 11)



Të punësuarit në sektorin publik janë më të prirur për të marrë pjesë në aktivitete të partive jashtë procesit zgjedhor, pasuar nga të punësuarit në sektorin privat dhe studentët.

Pjesëmarrja në aktivitete jashtë proceseve zgjedhore të partisë




FIGURA 11.

Pyetja: A keni marrë pjesë në ndonjë aktivitet të një partie politike jashtë procesit zgjedhor?

Edhe pse vetëm 6.4% e respondentëve pohojnë se janë shumë të gatshëm të marrin pjesë në konsultime në lagje të organizuar nga ndonjë parti politike, më shumë se gjysma apo 56.9% shprehen se janë “deri diku” të gatshëm. Kjo kategori merr shumicën e përgjigjeve të të dy gjinitë (mbi 55%) dhe të të dy llojet e vendbanimeve, por me theks më të veçantë në ato urbane (66%). Sa i përket etnive, serbët janë dukshëm më të gatshëm të dalin në konsultime të partive politike se sa shqiptarët, me 25% dhe 6.5% respektivisht. Përqindje të ulta të përgjigjeve “shumë gatishmëri” marrin të gjitha grupmoshat, ndërsa përgjigja “deri diku” i ka shumicën e përgjigjeve të të gjitha grupmoshat. Sa i përket nivelit të edukimit, respondentët me fakultet dhe me magjistraturë/doktoraturë janë më të gatshmit t’i përgjigjen pozitivisht ftesës së ndonjë partie politike për konsultim në lagje (16.7% dhe 12.5% respektivisht). Interesim më të lartë krahasuar me kategoritë e tjera tregon grupi i të punësuarve në sektorin publik, ndërsa asnjë respondentë në tri kategoritë me të ardhurat personale më të larta nuk kanë dhënë përgjigje pozitive sa i përket pjesëmarrjes në konsultime të organizuara nga ndonjë parti. Këto kategori janë përgjigjur me “deri diku”. Në fakt dy grupet me të ardhura më të larta mujore, në masë të madhe janë përgjigjur me “nuk di/refuzoj”. + (SHIH FIGURËN 12)

Arsyet kryesore për pjesëmarrje në aktivitete të partive politike jashtë proceseve zgjedhore janë si vijon: të qenurit simpatizant i një partie të caktuar politike (46.4%), dëshira për t’u informuar rreth aktiviteteve të saj (22.9%), si dhe të qenurit anëtar i një subjekti të tillë (18.2%).

25.2% e të anketuarëve burra janë anëtarë të një partie, ndërsa për gratë ky numër është vetëm 10%. Respondentët e vendbanimeve rurale dhe urbane nuk kanë ndonjë dallim të theksuar në përgjigje dhe kryesisht marrin pjesë në aktivitete të kësaj natyre, sepse janë simpatizantë të partisë organizatore apo për t’u informuar rreth veprimtarisë së saj. Po ashtu në mes të etnive nuk ka ndonjë dallim të theksueshëm në përgjigje, përveç se tek etnia serbe numri më i madh i përgjigjeve është “për t’u informuar rreth veprimtarisë së partisë”. Sa i përket grupmoshës, shumica e përgjigjeve rezultojnë të jenë “jam simpatizant i një partie”, ndërsa marrja pjesë për shkak të anëtarësisë është më e madhe për rininë (18-24 vjeç) dhe për moshën 55-64 vjeç. Nga të gjitha llojet e punësimit, të pensionuarit kryesisht marrin pjesë në aktivitete për shkak të anëtarësisë në parti (45.5%), ndërsa grupi që e ka përzgjedhur më së paku këtë përgjigje janë amviset (5.9%). Sa i përket kategorisë sipas të ardhurave personale, më shumë respondentë të grupit që fitojnë 451-600 euro në muaj janë anëtarë të partisë dhe prandaj marrin pjesë në aktivitete të saja edhe jashtë procesit zgjedhor. + (SHIH FIGURËN 13)

Gatishmëria për pjesëmarrje në konsultime në lagje të organizuara nga partitë




FIGURA 12.
Pyetja: A do të merrnit pjesë në ndonjë konsultim në lagjen tuaj të organizuar nga ndonjë parti politike?

Arsyet e pjesëmarrjes në aktivitete jashtë proceseve zgjedhore të partive




FIGURA 13.
Pyetja: Pse keni marrë pjesë në ndonjë aktivitet të një partie politike jashtë procesit zgjedhor?

V. AKTIVIZMI QYTETARË

1. Veprimet e ndërmarra në relacion me komunën

Nga pesë veprimet e dhëna si opsione nga të cilat respondentët kishin mundësi të zgjedhnin, 16.3% janë deklaruar që në të kaluarën kanë kërkuar takim me kryetarin, 9.9%

janë përgjigjur se i kanë telefonuar komunës për ankesa/kërkesa, 9.4% kanë kontaktuar me komunën apo kryetarin përmes rrjeteve sociale dhe vetëm 3.8% kanë raportuar online për ndonjë ankesë. Mirëpo, 68.1% e të anketuarëve nuk e kanë ndërmarrë asnjëherë ndonjërin nga këto pesë veprime.

Veprimet e ndërmarra në relacion me komunën




FIGURA 14.
Pyetja: Cilat nga këto veprime i keni ndërmarrë në të kaluarën?

2. Iniciativat qytetare në lagje

Më shumë se një e treta (1/3) e të gjithë respondentëve kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në ndonjë nga takimet e organizuara nga banorët e lagjes. Burrat dalin të jenë më të interesuar për pjesëmarrje në këso lloj takimesh, pasi pothuajse gjysma e respondentëve burra janë përgjigjur se kanë marrë pjesë në një të tillë, ndërsa vetëm 27.8% e grave kanë dhënë të njejtën përgjigje. Ndërsa, rezultatet nuk ndryshojnë shumë në mes të banorëve të vendbanimeve rurale dhe urbane. Ndër respondentët shqiptarë ka pasur më shumë pohime për pjesëmarrje në takime të lagjes (39%), pasuar nga serbët me 31.3%. Vlen të theksohet se përqindja më e lartë e qytetarëve aktiv janë grupet e etnive tjera. Në mesin e grupmoshave prej 45-54 vjeç ka më shumë përgjigje pozitive (47.3%), pasuar nga ata prej 25-34 vjeç (41.4%). Numri i përgjigjeve pozitive rritet në proporcion me nivelin e edukimit, duke filluar nga 39% të atyre me shkollë të mesme e deri në 45.2% tek ata me magjistraturë/doktoraturë. Në mesin e respondentëve sipas të ardhurave personale, ata që fitojnë 301-450 euro dhe 451-600 euro në muaj kanë pranuar se kanë marrë pjesë në ndonjë nga takimet e organizuara nga banorët e lagjes, e atë më shumë se grupet e tjera. + (SHIH FIGURËN 15)

3. Peticionet

Në përgjithësi qytetarët janë të gatshëm për të nënshkruar peticione për çështje të ndryshme lokale, me pothuajse 60% të respondentëve të cilët janë përgjigjur pozitivisht. Gatishmëria është e ngjashme ndërmjet dy gjinive dhe ndërmjet qytetarëve që jetojnë në vendbanime rurale dhe urbane. Në anën tjetër, shqiptarët dalin të kenë gatishmëri më të madhe për të nënshkruar një petition sesa serbët me 61.8% dhe 48% respektivisht. Sa i përket grupmoshave të ndryshme, nuk ka ndonjë dallim të theksuar, përveç gatishmërisë më të lartë në mesin e të rinjëve. Ndërsa tek grupet e ndryshme të punësimit dhe edukimit, edhe pse dallimet janë të vogla në mes të grupeve të respondentëve, studentët, qytetarët me nivel baçelor të edukimit dhe të punësuarit në sektorin privat, kanë treguar më shumë gatishmëri për të nënshkruar një petition. Te grupet e ndryshme sipas të ardhurave personale, dy grupe që dallohen nga të tjerat janë ata që fitojnë deri në 150 euro në muaj dhe ata që fitojnë në mes të 751-900 euro. + (SHIH FIGURËN 16)

Fakti që 48.2% e respondentëve janë përgjigjur me "nuk më ka pyetur askush" për ta nënshkruar një petition, tregon për mungesën e iniciativave të qytetarëve për të ndërmarrë hapa konkret për përmirësim të lagjeve/vendbanimeve të tyre. Përgjigjet janë të ngjashme ndërmjet burrave dhe grave, ku shumica kanë deklaruar se nuk u është kërkuar ndonjëherë për të nënshkruar petition, pasuar me përgjigjen "nuk mendoj që kanë efekt". Ngjashëm janë përgjigjur edhe respondentët e vendeve urbane me ata të vendeve rurale, ku në të dyja grupet dominon përgjigja "nuk më ka pyetur askush". Në mesin e respondentëve serbë ka ndarje në mes të përgjigjeve të ndryshme, ku një pjesë e konsiderueshme janë përgjigjur edhe me "nuk di/refuzoj". Respondentët e të gjitha grupmoshave kryesisht kanë thënë se nuk janë pyetur nga askush, pasuar me opinionin se peticionet nuk kanë ndonjë efekt. Ngjashëm mendojnë respondentët e të gjitha kategorive të punësimit, ndërsa pensionistët dhe të papunët kanë deklaruar më shumë se të tjerët se nuk janë pyetur nga askush. Sa i përket nivelit të edukimit, respondentët më të arsimuar, kryesisht mendojnë se peticionet nuk kanë efekt. Të gjithë respondentët në dy kategoritë e respondentëve me pagat më të larta kanë deklaruar se nuk u është kërkuar për të nënshkruar një petition, ndërsa ata që fitojnë nga 451-600 euro dhe 601-750 euro në muaj, në masë të madhe nuk ju kanë besuar iniciatorëve të petitionit. + (SHIH FIGURËN 17)

Pjesëmarrja në takimet e organizuara nga banorët e lagjes





FIGURA 15.
Pyetja: A keni marrë pjesë në ndonjë takim të organizuar nga banorët e lagjes?

Gatishmëria për të nënshkruar peticion për çështje lokale

Gjithë Kosova



PO
59.7%




FIGURA 16.
Pyetja: A do të nënshkruanit ndonjë peticion për ndonjë kauzë/çështje lokale?

Arsyet e mosnënshkrimit të ndonjë peticioni






FIGURA 17.
Pyetja: Pse nuk keni nënshkruar ndonjë peticion?

VI. INFORMIMI I QYTETARËVE PËR AKTIVITETET E NIVELIT LOKAL

Një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve kanë thënë se informohen për aktivitete të komunës përmes rrjeteve sociale (56.7%) dhe televizionit (49.9%). Burime tjera të informimit janë edhe ueb-faqja e komunës, shpalljet publike dhe radio. Grupmoshat e ndryshme (Shih shtojcën 5) informohen nga burime të ndryshme për aktivitetet e komunës së tyre. Është e pritshme që grupmoshat më të reja përdorin më shumë rrjete sociale, andaj ueb-faqen e komunës e shohin si burim informacioni, ndërsa televizioni dhe ra-

dio janë mjete informimi më të shpeshta për moshat më të mëdha, kjo sa i përket aktiviteteve të komunës së tyre. + (SHIH FIGURËN 18)

Mjetet e informimit për aktivitetet e komunës



+ FIGURA 18.
Pyetje: Si informoheni për aktivitetet e komunës?

Gjatë vitit të fundit, vetëm 23% e respondentëve kanë komunikuar me ndonjë nga zyrtarët publik, qoftë nga niveli lokal apo ai qendror. Nga këta, 27.8% janë burra dhe 19.3% janë gra. Respondentët që jetojnë në vende urbane kanë pasur më shumë komunikim me zyrtarë publik sesa ata që jetojnë në vende rurale, edhe pse diferenca nuk është edhe aq e theksuar, me 25.6% dhe 21.8% respektivisht. Më shumë qytetarë të etnisë serbe (35.3%) kanë pasur komunikim me zyrtarë publik në vitin e fundit sesa ata shqiptar (24.1%). Ndërsa sa i përket moshës, grupmosha 25-34 vjeç ka pasur më shumë respondentë që kanë pasur komunikim me zyrtarë publik (31.7%). Përqindja e përgjigjeve pozitive në këtë pyetje rritet proporcionalisht me nivelin e edukimit, duke arritur maksimalen e 35.5% për respondentët që mbajnë titullin master/doktor shkence. I njëjti trend pak a shumë vërehet edhe te grupet me të ardhura të ndryshme personale, ku në të dy grupet që fitojnë më

shumë (751-900 euro dhe mbi 900 euro në muaj) ka pasur më shumë respondentë (42.9% dhe 40% respektivisht) që janë shprehur se kanë takuar zyrtarë publik gjatë vitit të fundit, krahasuar me respondentët me të ardhura tjera. Ndërsa, sa i përket punësimit, të punësuarit në sektorin publik, për arsye të qarta janë grupi me më shumë përgjigje pozitive në këtë pyetje (31.4%), pasuar nga të punësuarit në sektorin privat (29.9%) dhe studentët (23.4%). + (SHIH FIGURËN 19)



Është e pritshme që grupmoshat më të reja përdorin më shumë rrjete sociale, andaj ueb-faqen e komunës e shohin si burim informacioni, ndërsa televizioni dhe radio janë mjete informimi më të shpeshta për moshat më të mëdha, kjo sa i përket aktiviteteve të komunës së tyre.

Komunikimi gjatë vitit të fundit me zyrtarë publik të nivelit lokal ose qendror

Gjithë Kosova



PO

23.6%




FIGURA 19.

Pyetje: A keni komunikuar gjatë vitit të fundit me ndonjë zyrtar publik lokal ose qendror?

Sa i përket çështjes se çfarë pozita mbajnë zyrtarët publik të cilët respondentët i kanë takuar në vitin e fundit, shumica dërrmuese janë përgjigjur se kanë qenë *këshilltarë komunal* (62.60%). Një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë takuar drejtorë të ndonjë drejtorie komunale (36%), një

pjesë kanë takuar kryetarin e komunës (24.5%), ndërsa një pjesë e vogël (14.1%) deputetë të Kuvendit të Kosovës, dhe një përqindje akoma më e vogël kanë takuar kryeministrin (4.2%) apo ndonjë ministër (2.3%). + (SHIH FIGURËN 20)

Komunikimi gjatë dy viteve të fundit me zyrtarë lokal/qendror




FIGURA 20.

Pyetje: Më kë keni komunikuar gjatë vitit të fundit me ndonjë zyrtar publik të nivelit lokal ose qendror?

VII. KËRKESAT E QYTETARËVE

Qytetarët kanë dhënë opinione të ndryshme se ku do të donin t'i investonin 100.000 euro, nëse komuna e tyre do t'i kishte ato mjete dhe nëse ata do të pyteteshin për këtë vendim. Kategoria me më së shumti përgjigje është investimi në shtëpi të shëndetit, dhe kjo përgjigje dominon në të gjitha kategoritë demografike, nivele të edukimit, punësimit apo grupet e ndryshme të të ardhurave personale (me një përjashtim të vogël). Përgjigjja tjetër më e përzgjedhura nga respondentët është investimi në infrastrukturë rrugore, e cila po ashtu ka përzgjedhje të ngjashme përgjatë kategorive të ndryshme demografike. Kjo pasohet me investim në mirëmbajtje të ambientit, e që shihet të jetë preokupim për të dyja gjinitë, për të gjitha grupmoshat, si dhe për të gjithë qytetarët pavarësisht nivelit të edukimit, punësimit dhe të ardhurave personale.

Sa i përket investimit që konsiderohet si më i nevojshmi (shtëpi të shëndetit me 24.4% në nivel të përgjithshëm), në përgjithësi krahasuar me opsionet e tjera, opinionin e përafërtë e kanë të dyja gjinitë, respondentët e vendbanimeve urbane dhe atyre rurale, dy etnitë, shqiptarët dhe serbët dhe secila grupmoshë. Variacion në përgjigje vërehet te niveli i edukimit, ku ata me shkollë të mesme janë idhtarë të këtij lloj investimi sesa grupet tjera, ndërsa grupi me përqindjen më të vogël janë respondentët që mbajnë titullin master/doktor shkence. Ngjashëm rënie të mbështetjes së kësaj ideje ka në grupet me të ardhura personale më të larta dhe kjo është lehtë e shpjegueshme, për faktin se personat me të ardhura më të larta kanë qasje dhe mundësi më të madhe në këto shërbime, për shkak edhe të klinikave apo spitaleve private. Sa i përket kategorive të punësimit, nevoja për ndërtimin e shtëpive të shëndetit ka më shumë mbështetje nga të punësuarit e sektorit privat dhe nga pensionistët, kjo krahasuar me grupet tjera. + (SHIH FIGURËN 21)



Kategoria me më së shumti përgjigje është investimi në shtëpi të shëndetit, dhe kjo përgjigje dominon në të gjitha kategoritë demografike, nivele të edukimit, punësimit apo grupet e ndryshme të të ardhurave personale (me një përjashtim të vogël).

Ku do ti investoje 100.000€ të komunës?





FIGURA 21. Pyetja: Nëse komuna vjen dhe ju thotë që i kanë 100,000 euro për t'i investuar në lagjen tuaj, ku do t'i thoni që t'i investojë?

Shërbimi që qytetarët e vlerësojnë se ka më së shumti nevojë për përmirësim është ndriçimi publik (57.3%), pasuar nga trotuarët (45.2%), mbledhja e mbeturinave (40.7%), rregullimi i gropave (38.2%), si dhe rregullimi i sinjalizimit të rrugëve (27%). + (SHIH FIGURËN 22)

Cilat shërbime duhet të përmirësohen në lagjen tuaj?



+ FIGURA 22. **Pyetje:** Cilat nga këto shërbime duhet të përmirësohen në lagjen tuaj?

VIII. ÇFARË QEVERISJE E VLERËSOJNË QYTETARËT

Shumica absolute e respondentëve në pyetjen se çfarë vlerësojnë më së shumti në një qeverisje, janë përgjigjur me opsionin “qeverisje pa korrupsion”. Në nivel të Kosovës, 60.6% e përgjigjeve janë në këtë kategori, ndërsa pjesa tjetër ndahet në “mbajtjen e premtimeve zgjedhore” (23.6%) dhe “udhëheqjen duke konsultuar qytetarët” (15%). Gratë dhe burrat mendojnë ngjashëm sa i përket rëndësisë së mbajtjes së premtimeve zgjedhore, por me një diferencë të vogël në opinion sa i përket rëndësisë së qeverisjes pa korrupsion (57.9% dhe 63.3% respektivisht) dhe qeverisjes duke konsultuar qytetarët (16.7% dhe 13.3% respektivisht). Respondentët shqiptarë kanë treguar pak më tepër vlerësim për mbajtje të premtimeve zgjedhore në krahasim me ata serbë, të cilët më shumë e vlerësojnë qeverisjen pa korrupsion. Serbët po ashtu vlerësojnë më shumë konsultimin me qytetarë gjatë qeverisjes sesa shqiptarët, e atë me 27.3% dhe 14.6% respektivisht. Te grupmoshat e ndryshme përgjigjet nuk ndryshojnë shumë, mirëpo mbi-zotëron përgjigja “qeverisje pa korrupsion”, pasuar nga “mbajtja e premtimeve zgjedhore” dhe “udhëheqja duke konsultuar qytetarët”. Po ashtu, as sipas shkallës së arsimimit nuk ka ndryshim të madh në përgjigje, përveç se grupi me grada më të larta arsimore (magjistraturë/doktoraturë) e vlerëson më pak se të tjerët udhëheqjen duke konsultuar qytetarët. Sa i përket kategorive sipas llojit të punësimit, përgjigja “qeverisje pa korrupsion” dominon në të gjitha kategoritë, ndërsa studentët

janë ata që kanë dhënë vlerësimin më të lartë krahasuar me të tjerët, ku për mbajtjen e premtimeve zgjedhore janë përgjigjur 27.7%, ndërsa për qeverisje në konsultim me qytetarët 18.1%. Në fund, sipas të ardhurave personale, përgjigjet e atyre që fitojnë më shumë dallojnë me grupet tjera. Përkatësisht, një e treta (1/3) e grupit që fiton 601-750 euro vlerëson dukshëm qeverisjen në konsultim me qytetarët, ndërsa ata që fitojnë mbi 900 euro në muaj vlerësojnë më së shumti qeverisjen pa korrupsion (53.3%) dhe mbajtjen e premtimeve zgjedhore (46.7%), por duke mos dhënë fare mbështetje për idenë e udhëheqjes duke konsultuar qytetarët. + (SHIH FIGURËN 23)

Shumica absolute (89.3%) e respondentëve mendojnë se gjinia mashkullore ka më shumë prirje të përfshihet në korrupsion në politikë. Ngjashëm mendojnë të dy gjinitë si dhe respondentët që jetojnë në zonat rurale dhe urbane. Sa i përket etnisë, shqiptarët janë më të binduar se burrat kanë më shumë prirje për t’u involvuar në korrupsion sesa serbët, me 90.1% dhe 76% respektivisht. Ndërsa, respondentët e të gjitha moshave dhe gjitha niveleve të arsimimit mendojnë bindshëm se gratë kanë më pak prirje për t’u korrumpuar sesa burrat (90%). Ngjashëm me këtë, të gjitha kategoritë sipas sektorit të punësimit dhe sipas të ardhurave personale, bindshëm kanë zgjedhur burrat në pyetjen se cila gjini ka më shumë gjasa të përfshihet në korrupsion gjatë jetës politike. + (SHIH FIGURËN 24)

Çka vlerësoni më së shumti në qeverisje?




FIGURA 23.
Pyetja: Çfarë vlerësoni më së shumti në qeverisje?

Cila gjini ka më shumë prirje për korrupsion në politikë




FIGURA 24.
Pyetja: Kush mendoni se ka më shumë prirje për korrupsion në politikë?

IX. PREMTIMET ZGJEDHORE DHE VOTA QYTETARE

Përgjigja që dominon në pyetjen se sa merren parasysh premtimet zgjedhore për vendimin se kujt t'i jepet vota, është "deri diku" (51.5%), pasuar me një ndarje të barabartë të përgjigjeve në mes të "shumë" (16.4%) dhe "pak" (16.4%). Burrat dhe gratë u kushtojnë nivel të ngjashëm të vëmendjes premtimeve zgjedhore, mirëpo gratë ka pasur më shumë përgjigje të kategorisë "aspak" (19.3% në krahasim me 13.7%). Respondentët nga vendet urbane u kushtojnë më shumë rëndësi premtimeve kur vendosin për kë të votojnë (21.7%) sesa ata në vendet rurale (11.6%), të cilët më shumë kanë përzgjedhur përgjigjen "pak" dhe "aspak". Ngjashëm është krahasimi në mes të etnive, ku shqiptarët dukshëm më shumë janë përgjigjur se i marrin shumë për bazë premtimet kur vendosin për kë të votojnë (17.4% në krahasim me 11.3%), ndërsa serbët kanë më shumë përgjigje në opsionet "pak" (28%) dhe "aspak"

(19.3%). Sa u përket grupmoshave të ndryshme dhe nivelit të edukimit, nuk ka ndonjë dallim të theksuar ndërmjet grupeve të këtij raporti në atë se sa i marrin për bazë premtimet kur votojnë. Ndërsa, te grupet e ndryshme të punësimit, nga studentët dhe të punësuarit e sektorit publik ka më shumë responentë që kanë thënë se u kushtojnë shumë vëmendje premtimeve, ndërsa në grupin sipas të ardhurave personale, kjo përgjigje zë vend më të madh në grupin që fiton 451-600 euro në muaj. Dy të gjetura që ja vlen të theksohen janë fakti që një e treta (1/3) e atyre që fitojnë 751-900 euro janë përgjigjur se nuk u kushtojnë aspak vëmendje premtimeve, ndërsa 6.7% e personave me të ardhurat më të larta (mbi 900 euro në muaj) i marrin shumë për bazë premtimet zgjedhore para se të vendosin se kë të votojnë. + (SHIH FIGURËN 25)

Sa i merrni për bazë premtimet zgjedhore kur votoni?





FIGURA 25.
Pyetja: Sa i merrni për bazë premtimet zgjedhore kur vendosni se kë do ta votoni?

X. SHTOJCAT


Shtojca 1 - Sa është e rëndësishme për ju që të konsultohuni nga komuna për këto procese, sipas moshës (rango 1- Aspak deri ne 5- Plotësisht për nga rëndësia)?

Preferencat për konsultim sipas moshës




Shtojca 2 - Për çfarë arsye nuk keni marrë pjesë në një konsultim publik të organizuar nga komuna, sipas moshës

Arsyet e mospjesëmarrjes në konsultime të komunës sipas moshës




Shtojca 3 - Për çfarë arsye keni marrë pjesë në një konsultim publik të organizuar nga komuna, sipas moshës

Arsyet për pjesëmarrje sipas moshës



Shtojca 4 - Cilat aspekte duhet të përmirësohen në lidhje me konsultimet publike për buxhet, sipas moshës

Çfarë kërkohet të përmirësohet në dëgjimet buxhetore sipas moshës



Shtojca 5 - Si informoheni për aktivitetet e komunës, sipas moshës

Mjetet e informimit për aktivitetet e komunës sipas moshës

